



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.11.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

Seancë dëgjimore me Autoritetin Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe të Luftës
Kundër Sigurisë Kibernetike, për projektbuxhetin e vitit 2020.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Myslim Murrizi, Elona Hoxha, Sadi Vorpsi, Antoneta Dhima, Luan
Duzha, Luan Harusha, Spartak Braho, Elena Xhina, Anduel Xhindi, Eljo Hysko, Edmond Rrushi,
Lefter Maliqi, Nimet Musaj, Ylli Shehu dhe Arlind Çaçani.

Mungojnë:

Të ftuar:

Vilma Tomço – drejtuese e Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe të Luftës
Kundër Sigurisë Kibernetike.

Edlira Gjollëshi - drejtore e Certifikimit Elektronik

Gentian Opre - drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Ndjesë për vonesën time për shkak të një takimi me përfaqësues të Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë!

Kolegë, në rendin e ditës së komisionit tonë kemi parashikuar të bëjmë një komunikim me përfaqësuesen e Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe të Luftës Kundër Cyber Security, zonjën Vilma Tomço dhe kolegët e saj: Edlira Gjollëshi, drejtore e Certifikimit Elektronik, dhe zotin Gentian Opre, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit.

Për kolegët që nuk kanë mundur të na ndjekin gjatë konferencës që mbajtëm për Cyber Security me komisionet homologe të Sigurisë së Europës Juglindore, dua t’ju them se ishte një rast shumë i mirë që patëm mundësi të njihnim nga afër autoritetin që drejton zonja Tomço dhe punën e tyre. Kjo ishte arsyeja pse vendosëm të bënim këtë komunikim në Komisionin Parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

Autoriteti i Certifikimeve Elektronike nuk ka ardhur më herët në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, por fusha ose përgjegjësitë që ai mbulon janë të tilla që lidhen edhe me komisionin tonë, sepse pjesa që i takon lufta kundër Cyber Crime është një pjesë tek e cila Autoriteti është investuar dhe ne si deputetë do të na vlente të mësonim diçka rreth funksionimit të tij, duke e lutur zonjën Tomço të na flasë në terma praktikë jo teknikë.

Njëkohësisht, meqenëse ky është një diskutim në kuadër të ligjit për buxhetin e vitit 2020, do të donim të njihnim edhe nevojat e institucionit tuaj, sepse, në fakt, institucioni në fjalë nuk është i përfaqësuar në nivel politik, me qëllim që edhe ne të japim suportin tonë duke konsideruar që përgjegjësia juaj është shumë e rëndësishme. Ju jeni institucioni i ngarkuar edhe për përfundimin e strategjisë kombëtare për Cyber Security dhe është gjë shumë e mirë që ne, nga pozitë tona si deputetë, të bëhemi suport i të gjithë punës dhe përgjegjësiave tuaja.

Faleminderit dhe mirë se keni ardhur!

Fjala është për ju.

Vilma Tomço - Ju falënderoj!

Është vërtet kënaqësi dhe nder që na keni ftuar, sepse tashmë ndjehemi edhe më tepër të vlerësuar në punën tonë.

Autoriteti ynë ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2017 si bashkim i dy agjencive të mëparshme AKCE dhe Agjencia për Sigurinë Kibernetike, të dyja të ngritura dhe në funksion, por me burime minimaliste. Ndaj, duke i kushtuar rëndësi elementit “siguri” si në shërbime dhe në infrastruktura kritike, u pa e nevojshme që të dyja këto agjenci të bashkohen në një autoritet të vetëm që ka funksione rregullatore, ligjvënëse, audituese dhe zbatuese të rregullave të vendosura.

Gjatë periudhës 2017-2019 Autoriteti është munduar të plotësojë kuadrin rregullator të ligjeve të miratuara të certifikimit elektronik dhe të Tranzit Service 2016, si dhe të Sigurisë Kibernetike të vitit 2017. Janë kompletuar me kuadrin rregullator, me akte dhe metodologji, si dhe me VKM-në më të rëndësishme mbi bazën e së cilës po vazhdojmë punën tonë, atë të miratimit të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, që do të thotë se kemi përcaktuar se cilat janë infrastrukturat që duhet t’u vendosim rregullat minimaliste të plotësimit në kuadër të sigurisë kibernetike dhe më tej kemi vazhduar me auditimin e këtyre infrastrukturave. Këtu përfshihen infrastruktura qeveritare dhe infrastruktura të tjera që ne i quajmë cifte sektoriale, sektori energjetik ku përfshihen kompanitë shtetërore KESH-i dhe OSSHT-ja. Në të ardhmen do të përfshihen edhe kompanitë private; sektori bankar ku kemi përfshirë bankat e nivelit të dytë. Jemi në proces të përfshijmë kompanitë jofinanciare, siç janë institucionet që raportojnë tek AMF-ja, pra të gjitha kompanitë e sigurimeve. Me këto subjekte jemi në proces dhe dakordësi; sektori i transportit ku momentalisht përfshihet ai ajrori, njëkohësisht, ajo që është më e rëndësishmja, do të vazhdojmë futjen e të gjitha infrastrukturave spitalore dhe shërbimeve shëndetësore në infrastrukturat kritike, sepse, bazuar në direktivat e BE-së dhe veçanërisht në direktivën IS, *e-health* konsiderohet si një nga sektorët më të rëndësishëm, të cilët janë hasur me sulme kibernetike dhe mendohet se janë informacionet më sensitive të të gjithë popullsisë.

Zotëria parafolës bëri një pyetje pse po merremi me infrastrukturat private, në fakt, ne nuk po bëjmë asgjë përtej direktivës, por gjithnjë nisemi nga fakti që çdo strukturë është në shërbim të qytetarit, pra ne mbrojmë vendin duke mbrojtur qytetarin dhe çdo përdorim i produkteve apo i shërbimeve të ofruara nga sisteme apo infrastruktura shtetërore publike dhe private, duhet të kalojnë në sitën e sigurisë kibernetike të vendit.

Në këtë moment, siç e përmendët edhe ju, jemi në fazën e përfundimit të draftit final të sigurisë kibernetike. Për këtë na kanë mbështetur partnerë ndërkombëtarë dhe po mundohemi të mbahemi në nivel minimalist në kuptimin që objektivat që do të përcaktohen në këtë strategji duhet

t'i realizojmë patjetër. Pra, të mos vëmë objektiva supermadhore dhe të bukura, të cilat mund të jenë të perealizueshme, por të bëjmë ato projekte që do të mund t'i realizojmë brenda vitit 2025.

Edhe buxheti i kërkuar për këtë vit është në kuadër të plotësimit të objektivave tona. Si fillim ne duam të ngremë Cirtin Kombëtar, që është detyrim ligjor, gjithashtu Autoriteti ka edhe tagrin e Cirtit Kombëtar, ndaj në këtë buxhet kërkuam krijimin e strukturës me një shtesë prej 7 ekspertësh dhe 2 projekte relativisht jo shumë të mëdha me qëllim që të kemi mundësi të rekrutojmë ekipin dhe më pas të fillojmë të implementojmë projektin për ngritjen e strukturës së plotë të Cirtit Kombëtar. Gjithashtu, kemi edhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë për ngritjen e procedurave dhe specifikimeve teknike për këtë sistem.

Në vijim, duke ditur rëndësinë që ka siguria kibernetike, shpresojmë që do të vijojmë edhe me ngritjen e Qendrës Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, që me shumë mundësi do të bëhet me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë, por ky është një projekt për vitet në vijim.

Me sa kam dijeni edhe nga Ministria e Financave, këtë herë janë treguar vërtet bujarë me ne për të gjitha gjërat që kemi kërkuar. Na janë bërë premtime rreth tyre, kështu që shpresoj të vijojmë në këtë linjë, në mënyrë që të realizojmë objektivin tonë.

Ermonela Felaj - Na vjen mirë që keni marrë paraprakisht suportin e kërkuar nga Ministria e Financave edhe për faktin se është e nevojshme që ne ta bëjmë vizibël institucionin tuaj dhe punën që bëni.

Gjatë konferencës që patëm, mësuam se edhe vende të tjera bëjnë përpjekje të shtuara në këtë pjesë, kështu që Shqipërisë nuk i takon të mbetet mbrapa edhe për një arsye të thjeshtë, do të thosha, legjislacioni që garanton funksionimin e institucionit tuaj dhe të të tjerëve, përgjithësisht është një legjislacion i ri, i cili shkon përkrah legjislacionit ndërkombëtar, kështu që ne mundemi ta pasurojmë me tej atë dhe ta bëjmë të vlefshëm për të gjithë.

Ka ndonjë pyetje nga kolegët?

Fjala për zotin Maliqi.

Lefter Maliqi – Për sa i përket votës, të jeni e sigurt që me këtë parlament i kalon 100 vota, por pyetja ime është: megjithëse morëm një informacion paraprak, sa vite ka që funksionon ky autoritet? Si është bërë përzgjedhja e ekspertëve? Dhe pyetja e drejtpërdrejtë është: nga këto kompani, biznese private apo institucione shtetërore a ka pasur denoncime dhe si ka qenë rezultati me Policinë e Shtetit dhe Krimin Ekonomik, meqenëse mbulohet kjo fushë?

Faleminderit!

Vilma Tomço - Në lidhje me pyetjen e parë, institucioni ynë është krijuar në vitin 2017 dhe, siç e thashë, është bërë bashkimi i dy agjencive të mëparshme, pra nuk është bërë rekrutim i ri.

Meqenëse gjatë vitit 2016 filluam të ecim dhe të kemi ide të reja, nuk patëm mundësinë për të rekrutuar staf të ri, na ka ndihmuar shumë edhe Kryeministria, kemi rekrutuar 4 të rinj që janë provizorë, me elemente intership të ekselencës domethënë me kontrata shtesë, mbaron viti, mbaron kontrata. Prurjet e reja janë gjithmonë pozitive për një institucion. Ne kemi nevojë për 7 ekspertë të rinj, të cilët do të kenë shumë nevojë të trajnohen dhe të kalojnë në një filtër tjetër, sepse, sado të mirë të gjejmë në treg, gjithnjë është e nevojshme të kalojnë të gjitha fazat e trajnimeve. Ata duhet të jenë inxhinierë elektronikë, informaticienë, por me prije drejt sigurisë kibernetike.

Doja t'ju thosha një informacion të vogël, që ndoshta nuk ju vlen, por është më tepër si kuriozitet: gjatë vitit të kaluar ne kemi bërë një *assessment* të vendit duke përfshirë universitetet se çfarë ofrojnë, çfarë kurrikulash kanë në cyber security, sepse ne dimë që universitetet prodhojnë specialistë IT-je, por jo cyber security, pra duhet një trajnim suplementar që një IT të bëhet siguri. Kështu që me ndihmën e një sponsori ne arritëm të bëjmë një studim ku vlerësuam se cilat janë universitetet që kanë kurrikula, master për cyber, numrin e studentëve, pedagogët nëse kanë aftësitë për të trajnuar studentët dhe më tej, duke ditur se cilat janë infrastrukturat tona kritike, vazhduam edhe me institucionet si publike dhe ato private nëse kanë ekspertë sigurie. Vërtetuam se vetëm Sektori i Telekomunikacionit dhe ai bankar kanë disa elemente sigurie, por jo të mirëfillta, ekspertët janë shumë të paktë. Kështu që nga e gjithë kjo, nxorëm konkluzionet se duhet të punojmë me kurrikulat e shkollave të larta, me kurset afatshkurtra, që një ekspert që tashmë ka dalë, të ketë mundësinë të trajnohet dhe specializohet. Pra, është një studim i plotë që do të japë shifrat. Në bazë të këtyre ka filluar një ndërgjegjësim si nga universitetet, ashtu edhe nga bizneset.

Kalojmë te pyetja e dytë: erdhëm dhe gjetëm një situatë që asnjëri nuk raportonte asgjë, domethënë fjalët i merrnim vesh si thashetheme, mund të jetë *hack*-uar kjo bankë apo një tjetër. Gjithçka ndodhte dhe ishte shumë e mbyllur. Kemi bërë dy-tre konferenca që lidhen me sigurinë kibernetike me mbështetjen e ndërkombëtareve gjatë këtij viti duke i thirrur të gjithë ekspertët me qëllim që edhe të shoqërizohen me njëri-tjetrin, të marrin vesh se në cilat kompani punojnë, por edhe të fillojnë të shkëmbejnë idetë dhe eksperiencat që kanë. Mendoj se kemi arritur një farë besueshmërie midis stafeve. Informacionet që marrim nga sistemet e NATO-s, mundohemi t'u

shpërndajmë dhe t'u japim informacione, si për shembull: “Po ndodh ky sulm në këto vende të botës, merrni masa dhe mbrohuni!”.

E mira e kësaj është se tani ekspertët e fushës kanë filluar të komunikojnë midis tyre dhe të paralajmërojnë njëri-tjetrin nëse ndodh diçka: “Na ndodhi një problem të cilin e zgjidhëm në këtë mënyrë. Jepuani këtë informacion edhe të tjerëve”.

Në këto momente jemi duke implementuar një sistem *online*, që tashmë do t'ua bëjmë detyrim ligjor. Ka edhe një penalitet për këtë që ai që nuk raporton, ndërkohë që i ka ndodhur një incident, do të penalizohet. Është pak e vështirë për ta matur këtë gjë, sepse po u mbajt sekret, asnjëri nuk merr vesh nëse është raportuar, por ne po mundohemi që të mos e zbatojmë këtë penalitet. Por është e rëndësishme të mësoni të raportoni. Kur ju ka ndodhur, si e keni zgjidhur? Ju e kaluat, por mund t'u ndodhë kolegëve të tjerë. Kjo gjë po fillon të funksionojë, jemi në shifra minimaliste që nuk ia vlen t'i raportojmë, por për mua ka rëndësi që po njihemi si sektor për *cybersecurity* si në nivelin privat ashtu edhe në nivelin qeveritar. Ky sektor ka shumë nevojë për trajnime, kështu që ne po vazhdojmë të bëjmë punën tonë që institucionet ndërkombëtare, të cilat na kërkojnë që të trajnohemi vazhdimisht, ta zbresim nivelin dhe të kërkojnë stafe më poshtë dhe kjo është pikërisht ajo që jemi duke bërë.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Tomcon!

Zoti Zeneli, fjala për ju.

Alban Zeneli – Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj gjithë të ftuarit!

Diskutimi në lidhje me anën teknike dhe profesionale të institucionit që ju drejtoni është i pafund, sidomos me zhvillimet e tejskajshme dhe të reja të *cyberi-t*. Meqenëse po diskutojmë buxhetin për institucionin tuaj, kisha një pyetje për ju. A i realizon objektivat që keni ju për vitin 2020, buxheti i propozuar nga Ministria e Financave, në lidhje me certifikimin elektronik, por sidomos për sigurinë kibernetike aq e rëndësishme për gjithë jetën e qytetarëve dhe të të gjitha institucioneve që ka vendi ynë?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Zeneli!

Zonja Tomcon.

Vilma Tomcon - Faleminderit!

Duke u bazuar edhe në ato që ne kemi kërkuar, janë dy projekte pak a shumë të rëndësishme në këto momente, njëri për ngritjen e një sistemi për trajtimin e incidenteve, por më tepër të gjërave keqdashëse që ndodhin në një sistem, kjo është mëse e nevojshme, si dhe ngritjen e dhomës së sigurisë, ku do të jenë të lidhur të gjitha sistemet që ne jemi duke ndërtuar. Ky është në nivel minimalist, pasi në të ardhmen do të kërkojmë më shumë projekte të tjera.

Ndërkohë, jashtë buxhetit të shtetit jemi duke punuar edhe me Organizatën Ndërkombëtare ITU, e cila po mundohet të na ndihmojë në ngritjen e procedurave. Pra, kjo do thotë se si bashkëpunojmë me institucionet, me parlamentin, me Kryeministrinë dhe me institucionet e tjera publike, private apo shtetërore në rastet e krizave të mëdha kibernetike. Pra, bëhet fjalë tashmë jo për një incident të vogël, por për kriza kibernetike, nëse sulmohet rrjeti energjetik, shëndetësor, ajror e të gjitha këto me radhë. Këto janë procedura që kanë ndikim në vend dhe ne jemi autoriteti që duhet t'i mbrojmë këto infrastruktura, duke iu përgjigjur kështu edhe incidenteve dhe krimit kibernetik që janë elemente të trajtuara nga Policia e Shtetit dhe këto veprime dënohen sipas Kodit të Procedurave Penale.

Alban Zeneli – Nëse ju kuptova mirë, normalisht vendi ynë ka nevojë për një projektligj me procedura sa më të sakta në lidhje me ecurinë e gjithë veprimtarisë suaj apo të institucionit që ju drejtoni në gjithë vendin tonë.

Vilma Tomcon – Unë mendoj që nuk bëhet fjalë për një projektligj, por do të jenë procedura, megjithatë kjo do të shihet në vijim se si do ta marrë formën ligjore. Ndërkohë, ne kemi deklaruar që deri në vitin 2022, gjë që e kemi deklaruar edhe te PKIE-ja, do të rishikojmë gjithë kuadrin ligjor të institucionit, duke përfshirë të tre ligjet, sepse jemi një institucion që funksionon me tre ligje, prandaj është mirë që të bëjmë edhe një përafrim të plotë me nismë direktivën e BE-së, si dhe me **EIDAS**-in që është direktiva për certifikimet elektronike dhe këto t'i nxjerrim një paketë ligjore të vetme. Ky është objektivi ynë deri në vitin 2022.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Normalisht duhen kuptuar të gjitha vështirësitë, pasi institucioni është i ri dhe deri tani ka bërë shumë përpjekje për të ardhur deri këtu.

Zonja Gjebrea, fjala për ju.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit zonja drejtoreshë dhe anëtarëve të institucionit tuaj!

Do t'ju bëj dy pyetje dhe ju kërkoj ndjesë, sepse erdha me vonesë, nëse do të jenë bërë paraprakisht. Sa e madhe është struktura juaj? Ndoshta kjo pyetje mund të jetë ezauruar.

Kam diçka në lidhje me pjesën e direktivave të BE-së, duke marrë shkas edhe nga një bisedë që u bë sot me një gjeneral amerikan të NATO-s me disa grupe interesi. I gjithë diskutimi kishte të bënte me sigurinë kibernetike, me kërcënimet që i vijnë jo vetëm vendin tonë, por gjithë rajonit dhe se çfarë masash duhen të marrim në lidhje me këtë. U përmendën disa direktiva të BE-së, të cilat janë nënshkruar apo janë përkthyer në rezoluta nga disa vende. A keni ju një *database*, ndoshta në këtë rast mund të ndihmohet edhe Kuvendin me të gjitha detyrimet e rezolutave apo të direktivave në lidhje me sigurinë kibernetike dhe pa dyshim edhe rolin tuaj? A jeni ju pjesë e *network-eve* të ngjashme dhe si bashkëpunoni me to?

Faleminderit!

Edlira Gjollëshi – Po e filloj edhe një herë nga e para, struktura. Në vitin 2017 kur...

Ermonela Felaj – Më falni, zonja Gjollëshi, është Drejtoresha e Certifikimit Elektronik.

Edlira Gjollëshi - Dikur kam mbrojtur edhe ndryshimet ligjore në komisione. kështu që procedurën e kam pak të hershme. Në fakt, numri 17-të nuk i korrespondon detyrimit të gjitha funksioneve që kryen Autoriteti, por në pamundësi, duke qenë se numri i punonjësve ishte shpërndarë në mars kur ne filluam me ligjin mbetëm te numri 17 kur u bë bashkimi i të dy institucioneve. Ne i kryejmë funksionet e cirtit, sepse ekspertët janë aty, në numër minimal sigurisht, por momentalisht duhet një strukturë më e madhe për cirtin kombëtar, siç e ka rekomanduar edhe Komisioneri European për të qenë më funksionale.

Dua t'ju them edhe diçka tjetër. Në të gjitha takimet që ne bëjmë me vendet e rajonit, dua ta theksoj se ne jemi vend pararojë në implementimin qoftë të ligjeve të kuadrit ligjor rregullator dhe të sigurisë kibernetike edhe për *Trans Servis*, qoftë për implementimin e tyre konkretisht. Ajo që ne bëjmë është imponimi i masave të sigurisë te të gjithë operatorët që administrojnë infrastruktura kritike, qoftë në sektorin privat apo atë publik dhe kontrolli ose inspektimi i këtyre masave dhe nëse ato janë implementuar në mënyrë korrekte nga operatorët.

E gjithë kjo është për të mbrojtur pjesën e afektimit të qytetarëve ndaj një sulmi kibernetik apo vjedhjes së të dhënave si dhe të të gjithë komponentëve që përmban siguria kibernetike. Nga ana tjetër, sipas ligjit të sigurisë kibernetike, ligjit nr. 2, të vitit 2017, sipas nenit 5, ne jemi si pikë koordinatore dhe kontakti për institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që ne përkthejmë të gjitha angazhimet e qeverisë si anëtare e Aleancës së NATO-

S dhe jemi të detyruar të marrim pjesë në të gjitha ushtrimet kibernetike dhe në takimet në bordin e NATO-s që kanë lidhje me sigurinë kibernetike, e cila është një ndër prioritetet e NATO-s së fundmi.

Gjithashtu, jemi duke përkthyer të gjitha angazhimet që vijnë nga OSBE-ja. Sa u takon *network-eve* jo vetëm me vendet e rajonit, por edhe më tej, falë edhe këtyre *network-eve* dhe marrëdhënieve të mira që kemi me vendet e tjera, u jemi përgjigjur disa sulmeve kibernetike që janë kryer nga Shqipëria në adresë të këtyre vendeve, duke i menaxhuar shumë mirë dhe kemi reaguar në kohë për zgjidhjen e këtyre incidenteve kibernetike. Mendoj se jemi në rrugën e duhur.

Vilma Tomcon – Dua të bëj një shtesë të vogël, që jemi duke u anëtarësuar në dy organizata ndërkombëtare në të cilat ndodhet rrjeti i të gjitha cirkuiteve të botës, *First-i*, që është i Amerikës dhe *Trans Introducior* i Europës, ku te kjo e fundit jemi futur, ndërsa te *First* jemi duke bërë aplikimin që të anëtarësohemi një herë dhe më pas të jemi anëtarë me të drejta të plota. Jemi në rrugë të mirë.

Ermonela Felaj- Faleminderit dhe punë të mbarë!

Dua t'ju bëj disa pyetje. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar në një prej detyrave që kryen është që të sigurohet edhe për sistemet në institucione të ndryshme qendrore nëpërmjet, të cilave bëhet i mundur shkëmbimi i informacionit të klasifikuar që mund të jetë informacion i NATO-s, i Bashkimit Europian apo të tjera. Në rastet kur kjo drejtori konstaton që sistemi ka mangësi dhe nuk është aq e sigurt hapësira ku ndodh shkëmbimi mund të ndërhyhet nga të tretët, ju informon? Dua të di nëse keni bashkëpunim dhe në çfarë niveli e keni atë me këtë drejtori? Pyetja e parë.

Disa herë në Shqipëri kanë ardhur drejtues të sigurisë së NATO-s, edhe herën e fundit jo më larg se para 2 javësh, pasi kam pasur rastin ta takoj, drejtori i Sigurisë për NATO-n, i cili është njëkohësisht edhe këshilltari i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s ishte në Shqipëri, ku patëm rastin ta takonim, unë kryesisht si kryetare e Komisionit të Sigurisë. Nuk e di nëse ka pasur takim me ju, sepse tani që po ju dëgjoj është diçka që ju e trajtoni dhe jeni të azhurnuar me të gjitha ato çfarë kërkon NATO në fushën e sigurisë.

Pyetja e dytë. Ju thatë se keni bashkëpunim me Kryeministrinë, Kuvendin e të tjera. Dua të di në çfarë forme dhe për çfarë ndodh ky bashkëpunim?

Po dal në një problem praktik. Ne si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë kemi adresat zyrtare, por shpeshherë informacioni që ndahet në këto adresa, mos të them gjithmonë përfundon

në Spam. Edhe pse e kemi ngritur këtë problem, sepse jo gjithmonë, informacioni është i tillë që përbën informacion që nuk duhet të jetë i hapur për publikun, por kjo gjë ndodh dhe nuk e di nëse raportohet diku? Të paktën në mbledhjet që bëjmë në Konferencën e Kryetarëve apo në Byronë e Kuvendit e kemi ngritur këtë problem, por ende vazhdon të jetë kështu, aq sa na detyron të përdorim adresat tona personale si adresa për të komunikuar në vend të adresave që duhej të ishin ato zyrtare.

Pyetja e tretë është sa i takon kurrikulës për edukimin *Cibersecurity* nëpër shkolla. Çfarë mendoni se duhet të bëjmë? Sot nëpër shkolla, duke filluar nga klasat e 6-ta merren njohuri për informatikën. Kjo ka qenë edhe më herët, pasi mbaj mend që para më shumë se 20 vjetësh kur isha vetë në shkollë të mesme filluam të mësonim informatikë. A mendoni që te njohuritë që merren për informatikën, gjithsesi janë njohuri fillestare bazë, është e nevojshme të futet edukimi për *cyber*? A kemi ne njerëz që mund t'i edukojnë fëmijët, pasi edhe në konferencë u theksua se është shumë e nevojshme të punohet për edukimin e tyre që në moshë të hershme. Fëmijët tanë gjatë gjithë kohës janë të dhënë pas mjeteve teknologjike dhe besoj se jeta e tyre do të jetë e lidhur fort me këto mjete, nuk mendoj të ketë një variant tjetër të dytë. Çfarë mund të bëjmë në situatën aktuale?

Në përfundim të përgjigjes së këtyre pyetjeve ajo që do të doja unë është: çfarë mendoni ju se mund të bëjmë ndryshe ne si deputetë të këtij komisioni? Pra, e thënë në mënyrë të sinqertë, si mundemi të ndihmojmë më shumë për këtë çështje? Pasi fakti që është pak e njohur nganjëherë merr pak vëmendje, por ndërkohë duhet të jemi koshient që vëmendja duhet të kthehet ndaj kësaj çështjeje.

Faleminderit!

Edlira Gjollëshi – Në lidhje me pyetjen e parë, që ka të bëjë me rrjetat e sigurta apo me informacionin që është i lidhur me kuadrin rregullator të DSIK-së, në ligjin e sigurisë kibernetike është thënë që janë përjashtuar dy elemente, të cilat jemi duke i rishikuar, rrjetat e klasifikuara të sigurta, të cilat janë objektiv i DSIK-së dhe rrjetat Telekom, të cilat janë objektiv i AKEP-it. Pra, janë dy elemente që nuk përfshihen në ligjin e sigurisë kibernetike.

Sa u takon rrjetave të Telekomit ekziston një klauzolë që të futen shërbimet që ofrohen nga këto rrjeta dhe atëherë këto do të konsiderohen si infrastruktura kritike, sepse i gjithë informacioni në fund të fundit kalon nga rrjetet e telekomunikacionit, edhe sulmet, viruset dhe

ndikimet vijnë nga këto rrjete. Ne jemi duke bashkëpunuar me AKEP-in për të bërë disa përshtatje dhe rregullime në VKM nr. 222 të infrastrukturave kritike.

Sa u takon rrjetave të klasifikuara, është një element i mbyllur i DSIK-së dhe ne nuk kemi asnjë komunikim me këtë lloj, por duhet ta shohim në të ardhmen se si do të vijojë. Këto gjëra janë të thëna në rregullat e tyre, por edhe në ligjet tona nuk kemi pika të...

(Diskutime pa mikrofon)

Janë strukturat që quhen NSA, të cilat janë të ndara dhe të palidhura me rrjetat që konsiderohen publike. Ne merremi me infrastrukturat shtetërore publike, ndërsa ato janë të klasifikuara me rrjetin e sigurt dhe të mbyllur. Ne u munduam që të mos kishim pikëprerje dhe mbivendosje edhe në aktin që DSIK-ja ka miratuar disa muaj më parë. U munduam të bashkëpunonim që të mos kishim ndërhyrje.

Sa i përket bashkëpunimit, pra nuk kemi bashkëpunim me Kuvendin, por me projektin që jemi duke bërë me ITU-në do të bëjmë të gjitha procedurat si duhet të veprojë një institucion në rast se është në sulm. Pra, kujt duhet t'i raportojë, nuk duhet ta mbajë të mbyllur. Ai që duhet të raportojë, duhet ta ketë pjesën e informacionit që do të japë në publik. Pra, nuk është aq e lehtë, një përgjithësi në sulm edhe në botë kur del në publik raportohet pas një viti, minimalja është 6 muaj. Pra, asnjëherë nuk raportohet në publik në momentin kur ndodh, që do të thotë se brenda kësaj periudhe institucioni duhet të rikuperojë dëmet që i kanë ndodhur. Pra procedura do të thotë që të gjithë duhet të lidhen me njëri-tjetrin dhe kanë një detyrë të caktuar për këtë gjë.

Sa i takon kurrikulës, ne kemi ndërmarrë një sërë nismash me fëmijët, jo vetëm t'i fusim elementet e sigurisë kibernetike në kurrikulat e klasave 6-9, por kemi marrë edhe një nismë shumë të gjerë me UNICEF-in për t'i kthyer vetë fëmijët në ndihmues, bashkëpunues dhe orientues të bashkëmoshatarëve të tyre, sepse, nga një studim i bërë fëmijët qajnë hallet më shumë me shokët se me prindërit dhe mësuesit, madje në shumë raste pamë se penalizoheshin nga prindërit ose mësuesit nëse i flisnin një të huaji në internet. Pra, autoriteti ka hartuar një metodologji për fëmijët me disa raste se si duhet të sillen nëse i ndodhin disa gjëra në internet. Kjo është një nga detyrat që autoriteti ka në lidhje me ndërgjegjësimin si për të rriturit edhe për fëmijët në kuadër të mbrojtjes së sigurisë kibernetike. Pra, e kemi në objektivin tonë që të rifillojmë një fushatë ndërgjegjësimi në disa nivele.

Ermonela Felaj – Zonja Gjollëshi është e mirëpritur të na thotë diçka më shumë, sepse dihet për fëmijët nuk kemi nevojë thjesht t'i mësojmë si ta përdorin, por të mos rrezikohen nga

pornografia në internet, nga lojërat e rrezikshme që u kanë marrë jetën fëmijëve, si për shembull, Balena Blu u bë shumë virale.

Është shumë e rëndësishme që fëmijët të mos bien pre e këtyre interferencave.

Edlira Gjollëshi – Nisur nga këto fenomene, në bashkëpunim me UNICEF-in, në vitin 2018 u bë një vlerësim i situatës se në çfarë mase përdoret interneti nga fëmijët dhe në çfarë moshe. Rezulton se ne jemi vendi ku fëmijët shqiptarë që në moshën 9 vjeç përdorin masivisht internetin, rrjetet sociale paurvejimin e prindërve dhe komunikojnë me njerëz të panjohur. Si pasojë e këtyre të dyjave, fëmijët shqiptarë preken më së shumti nga problematikat e internetit. Ne kemi klasifikuar disa problematika, në fakt, në këtë manual që e kemi punuar bashkë me UNICEF-in, i cili quhet “Këshilluesit e vegjël online”. Bashkëlidhur këtij manuali ne kemi punuar një formë loje për t’i argëtuar fëmijët dhe ata të këshillohen të edukohen kundrejt qasjes së internetit. Kemi zhvilluar trajnime me 312 fëmijë në 7 rajone të vendit, të cilët së bashku me ne kanë trajnuar fëmijët e tjerë të shkollës së tyre ku janë. Gjithsej brenda një viti kemi ndërgjegjësuar rreth 15 mijë fëmijë në rang vendi. Ajo që vihet re është se pjesa e ndërgjegjësimit të këtyre fushatave është detyrim ligjor. Ne e kemi filluar nga fëmijët dhe nga institucionet që administrojnë infrastruktura kritike, por sigurisht që është gjithë pjesa e shoqërisë për t’u ndërgjegjësuar. Ne jemi shoqëri që masivisht përdorim rrjetet sociale dhe të dhënat i japim pa hezitim në çdo lloj portali ose siti që futemi pa pyetur për rrezikun. Kjo është një ndër sfidat tona në vitin që vjen. Ne do të merremi me pushtetin vendor, që është një ndër shtyllat në lidhje me ndërgjegjësimin e këtyre institucioneve, ose infrastrukturave kritike duke qenë se ofrojnë shumë shërbime për qytetarët dhe në shërbimet e tyre mbledhin të dhënat sensitive të qytetarëve, siç është ajo për taksat vendore, që ishte një nga shërbimet që duhet të kenë sistem të mbrojtur që aplikon masa sigurie në kuptimin e ligjit për sigurinë kibernetike. Pjesa e ujësjellësit është një ndër shtyllat ku merren masa për mbrojtjen e sistemeve.

Sa i përket futjes së kurrikulave në shkolla, ajo që vihet re është një etje për dijen në këtë fushë, jo vetëm nga nxënësit, por edhe nga mësuesit. Duke qenë se ne kemi bashkëpunuar edhe me Ministrinë e Arsimit për këtë gjë dhe jemi duke bashkërenduar punën për ta pasuruar kurrikulën shkollore, në lidhje me pjesën e sigurisë së fëmijëve në ambientin online, një ndër hapat e tjerë që do të merret bashkë me Ministrinë e Arsimit dhe me IZHA-n, është trajnimi i mësuesve për pjesën e sigurisë së fëmijëve në internet. Sigurisht që është një punë kolosale, sepse gjithçka duhet të jetë

pranë shkollës duke qenë se edhe ritmet e jetës janë shumë dinamike, është pjesa e ndërgjegjësimit është goxha e vështirë.

Në lidhje me emailët e sigurt që ju përmendët, në bazë të ligjit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, edhe sipas ligjit për nënshkrimin elektronik pjesa e ndryshimeve që ka ardhur në vitin 2016, një ndër to është edhe pjesa e emailëve që përdoren me nënshkrim elektronik, që do të thotë që të gjitha emailët që aksesohen me nënshkrim elektronik janë emailë të sigurt, përveç të tjerave këtë e rregullon edhe pjesa e një sistemi të sigurt të mbyllur, siç janë sistemet e NATO-s. Për institucionet me rëndësi të veçanta edhe për komunikimin me institucione të veçanta duhet të aplikohet një sistem sipas kriterëve të NATO-s, siç është informacioni i klasifikuar.

Luan Duzha- Ju jeni një institucion i ri dhe, ashtu sikurse e thatë edhe ju, keni nevojë për njerëz që të trajnohen. Sa i përket buxhetit sikur nuk keni asnjë zë, asnjë kërkesë fondesh për trajnim. Si mendoni se do ta zgjidhni këtë?

Edlira Gjollëshi- Nuk kemi futur si zë trajnimin, sepse ne themi se është e pamundur të trajnosh kur themi që nuk kemi kapacitete në universitete. Këtë e kemi futur te zëri i shpenzimeve, nuk është i dukshëm, por te shpenzimet ne kemi zërin tonë, pak a shumë e kemi të mbuluar. Për aq veta sa jemi, themi se mjafton, nuk mund të vëmë trajnime, nuk mund të vëmë të njëjtët njerëz, shpresojmë që të na vijnë të rinj dhe t'i trajnojmë. Ata që kemi, i kemi të trajnuar.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Me bashkëpunime me institucione ndërkombëtare.

Operojmë me bashkëpunime. Për shembull, në bashkëpunimin me OSBE-në është OSBE-ja që e lidh të gjithë këtë pjesë. Ndërkohë, ne kemi marrë një nismë në kuadër të studimit që tha edhe drejtoresha, është i treti vit që ne si institucion me forcat tona kemi ngritur një akademi modeste me shkollë verore, që i vjen në ndihmë studentëve që janë të profilizuar tek teknologjia e informacionit për të marrë leksione shtesë. Këtë e bëjmë në bashkëpunim me ndërkombëtarët. Ne sjellim profesorë të kualifikuar nga vendet e tjera dhe organizojmë këtë event për t'i orientuar të gjithë studentët drejt kësaj fushe dhe për të rritur kapacitetet e tyre.

Ermonela Felaj - Po praktika profesionale, a organizoni ju për studentët e informatikës dhe inxhinierisë?

Edlira Gjollëshi – Po.

Ermonela Felaj– A ka interes për të ardhur?

Edlira Gjollëshi -Po ka shumë.

Ermonela Felaj – A janë praktika të paguara?

Edlira Gjollëshi- Janë praktika të papaguara.

Ermonela Felaj - A keni pyetje të tjera?

Faleminderit!

Edhe për ne është një fillim, por shpresojmë se të gjitha ato që kemi pasur rastin të mësojmë nga puna juaj të mundemi realisht të jemi konkretë në ndihmën që mund t’ju japim qoftë në instrumentin ligjor, por qoftë edhe në instrumentin financiar që garanton shumë nga puna juaj.

Ju urojmë punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.11.2019, ora 14:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me Ministrinë e Mbrojtjes për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Alban Zeneli, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Paulin Sterkaj, Anduel, Luan, Elona Hoxha, Sadi Vorpsi, Luan Harusha, Antoneta Dhima, Elena Xhina, Myslim Murrizi, Arben Elezi, Lefter Maliqi, Edmond Rrushi, Ylli Shehu, Nimet Musaj dhe Edmond Stojku

Mungojnë:

Të ftuar:

Petro Koçi – Zëvendësministër i Mbrojtjes

Bardhyl Kollçaku - Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura

Florian Kali - Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes

Nuri Laknori - Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Mbrojtjes

Gentian Opre - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj - Mirëdita!

Mirë se keni ardhur!

Sot në rendin e ditës të mbledhjes së Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, përveç dëgjësës që patëm me Autoritetin Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe të Luftës Kundër Sigurisë Kibernetike, kemi edhe një dëgjësë për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020” me Ministrinë e Mbrojtjes.

Për të prezantuar projektligjin kemi të ftuar zotin Petro Koçi, zëvendësministër i Mbrojtjes, i shoqëruar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, zoti Bardhyl Kollçaku, nga zoti Florian Kali, sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe nga zoti Nuri Laknori, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. Bashkë me ne është edhe zoti Gentian Opre, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, nga Ministria e Financave i cili ka qenë edhe në mbledhjen e mëparshme.

Ndjesë për kohë që na duhet të fillojmë, por i kemi të gjitha mundësitë për të bërë një parashtrim të gjithë buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2020.

Zoti Koçi, ju lutem të jeni praktik në diskutimin e projektbuxhetit, duke pasur një qasje ndryshe nga ato të viteve të tjera! Le të përqendrohemi tek të rejat që përcjell buxheti i vitit 2020 në terma praktikë. Buxheti që ju akordohet nga qeveria, ose që planifikohet t’ju jepet a është i mjaftueshëm për objektivat që Ministria e Mbrojtjes ka për këtë vit? Çfarë synohet të bëhet me këtë buxhet? Ku do të jenë fokusat kryesore të përdorimit të këtij buxheti?

E bëra këtë ndërhyrje për shkak se Komisioni i Sigurisë për më shumë se dy vjet aktivitet gjatë kësaj legjislature, ka ndërmarrë vizita në shumicën dërrmuese të institucioneve të sigurisë dhe mbrojtjes, kështu që ka një ide shumë të qartë për nevojat e posaçme që kanë këto institucione. Ne do të dëshironim shumë paraprakisht që të njëjtat nevoja të ishin në pikësynimet tuaja, që buxheti të mund, sado pak, t’i afrohet plotësisht të këtyre nevojave.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen!

Fjalën do t’ia kaloj zotit Koçi, që të na bëjë parashtrimin dhe më pas relatorit për çështjen në fjalë.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Sigurisë Kombëtare!

Për mua dhe shefin e Shtabit, por dhe për ekipin që na shoqëron është një kënaqësi që në rendin e takimeve dhe marrëdhënieve të vazhdueshme që kemi si ministri me ju, jemi të pranishëm në një nga momentet më të rëndësishme të kësaj marrëdhënieje, sepse dihet që është parlamenti ai që aprovon buxhetin e shtetit, përfshirë dhe shpenzimet për mbrojtjen në Republikën e Shqipërisë.

Gjëja e parë që dua t'ju them, para se të kemi ndonjë prezantim më të hollësishëm, është që buxheti për vitin 2020 për mbrojtjen vjen me rritje. Besoj se ky trend rritës që ka ndjekur buxheti i mbrojtës vit pas viti është prova më e qartë e vendosmërisë së qeverisë sonë dhe e maxhorancës për t'iu përmbajtur angazhimeve tona ndaj aleancës dhe partnerëve qoftë në terma financiarë, pra duke rritur gradualisht buxhetin derisa ta çojmë në 2% të PBB-së për vitin 2024, qoftë në terma konkretë, pra në terma të modernizimit dhe rritjes së kapaciteteve të FA-së, apo në terma të përballimit të kërkesave, që na vijnë për të kontribuar në misionet e aleancës dhe së shpejti në ato të OKB-së, apo kudo tjetër që do të jetë e nevojshme në përputhje me politikat e Republikës Shqipërisë.

Në fakt, akti normativ dhe shtesa e buxhetit me fokus kryesor të misionet ndërkombëtare të Shqipërisë ishte një tregues edhe më i qartë i këtij angazhimi.

Pra projektbuxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2020 ndjek një trend rritës dhe ne, si ministri dhe si drejtues të kësaj ministrie jemi optimistë që gradualisht po na lejon rritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve të mbrojtjes së vendit tonë, me qëllim vijimin e përmbushjes së objektivave në planin kombëtar dhe të detyrimeve që kemi ndaj NATO-s.

Treguesi më i qartë i këtij trendi janë tavanet buxhetore të Ministrisë së Mbrojtjes të miratuara me vendimin nr. 523, datë 25.07.2019 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së (Programi Buxhetor Afatmesëm) 2020-2022”. Në zbatim të këtij vendimi, shpenzimet e Ministrisë së Mbrojtjes për këto vite janë si më poshtë:

Për vitin 2019 shkoi në 1,26 të PBB-së, pra 16% e buxhetit është investime, për vitin 2020 shkon në 1,33, buxheti për investime shkon në 19%, për vitin 2021 shkon në 1,49% të PBB-së dhe nga kjo 26% do të shkojë për investime. Ndërkohë për vitin 2022, që është viti i fundit i PBA-së, shkon në 1,75 në raport me PBB-në dhe 33% e këtij buxheti shkon për investime. Më konkretisht, për vitin 2020 projektbuxheti i Ministrisë së Mbrojtjes është parashikuar të jetë 24 miliardë e 798 milionë e 845 mijë lekë krahasuar me 18,532,417 lekë që ishte për vitin 2019. Pra, e parë në raport me PBB-në buxheti i këtij viti është 1,33% nga 1,26 që ka qenë vitin që po mbyllim, pra janë rreth 6 miliardë lekë më shumë që i shtohen buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Kjo është një shifër e konsiderueshme, që do të na lejojë të ndjekim dhe zgjerojmë disa programe kyçe në procesin e modernizimit të FA-së, por edhe të përmbushim detyra të reja që ka Ministria e Mbrojtjes, të cilat fokusohen në garantimin e sigurimit së qytetarëve në raste emergjencash dhe që kanë pasur më ndikim kohët e fundit në përballimin e këtyre emergjencave, duke konsideruar edhe rritjen e prekshme të kapaciteteve tona financiare. Por kjo rritje tregon vetëm një pjesë të historisë, sepse miradministrimi i financave, i burimeve, i goditjes së abuzimeve apo i shpërdorimeve nga të cilat mbrojtja ka vuajtur shumë gjatë 30 vjetëve të fundit, impakti i kësaj rritjeje në terma realë është më i dukshëm dhe më i prekshëm.

Nga ana tjetër, rritja e buxhetit shoqërohet me një rritje të raportit të shpenzimeve për kapitale të brendshme, investime (artikulli nr. 231). Këtë vit kjo kategori shpenzimesh ishte në masën 16% të buxhetit të mbrojtjes, ndërsa për 2020-ën shkon në 19%, duke hedhur kështu një hap shumë të madh përpara në përmbushjen e detyrimeve, që ka marrë qeveria shqiptare në Samitin e Wells-it, për ta çuar në 2% të PBB-së për vitin 2024.

Ky buxhet duhet parë edhe si një deklaratë politike e seriozitetit të qeverisë për të përmbushur çdo detyrim dhe angazhim që kemi marrë ndaj aleatëve dhe NATO-s, të marra këto në Samitin e Wells-it, të rikonfirmuara edhe në forume të tjera të NATO-s dhe në kontaktet me aleatin tonë strategjik, SHBA-të.

Të vijmë te një diskutim më i hollësishëm! Ky buxhet do të ndahet në shpenzime korrente, pra mallra, shërbime, totali i të cilave planifikohet të jetë 20 miliardë e 78 milionë e 845 mijë, ndërsa shpenzimet kapitale të brendshme dhe investimet, planifikohen në masën 4 miliardë e 720 milionë lekë. Siç shihet edhe nga treguesit financiarë aktualë, buxheti siguron vazhdimësinë e zhvillimit të reformave në fushën e mbrojtjes, si dhe në përmbushjen e detyrimeve tona, për plotësimin e objektivave të kapaciteteve, të gjitha këto të koordinuara ngushtësisht me strukturat e NATO-s.

Dua të theksoj se muajin e kaluar ka pasuar një diskutim dypalësh kuadër të DPCS-së (*Defence Planning Capability Survey*), që është një proces 2-vjeçar ciklik që rakordohet mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe NATO-s lidhur me politikat dhe angazhimet financiare.

Kërkesat buxhetore që paraqesim këtu janë hartuar nga Ministria e Mbrojtjes në përputhje me programet e mbrojtjes dhe janë produkt i bashkëpunimit të strukturave të FA-së, të të gjitha niveleve të komandë-kontrollit.

Ky është një element i ri, që tashmë është kthyer në praktikë për dikasterin e mbrojtjes sidomos në fazën e hartimit të projektbuxhetit, mbledhjen mendimet, idetë, nevojat dhe kërkesat e të gjitha niveleve të komandimit për të arritur në një dokument që përmbush sa më mirë nevojat e FA-së. Programimi për buxhetin është në përmbushje të misionit kushtetues të FA-së dhe mbështetet në strategjinë e sigurisë kombëtare dhe ushtarake, në planet afatgjata të zhvillimit të FA-së 2019-2025, në planin e kapaciteteve operationale dhe në kërkesat e objektivave të kapaciteteve. Të gjitha këto janë seti i dokumenteve, që janë respektuar në hartimin e këtij buxheti. Buxheti i mbrojtjes do të përdoret për mbështetjen e programeve të mbrojtjes të parashikuara për vitin 2020 të hartuara sipas këtyre drejtimeve:

1. Mbështetja për personelin,
2. Operacionet brenda dhe jashtë vendit dhe emergjencat civile, duke synuar zgjerimin e pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura në misionet jashtë vendit,
3. Gatishmëria dhe mirëmbajtja,
4. Stërvitjet,
5. Arsimimi dhe kualifikimi,
6. Strukturat dhe angazhimet ndërkombëtare,
7. Modernizimi,
8. Infrastruktura,
9. Mbështetja me mallra dhe shërbime ,
10. Mbështetje administrative,

Më lejoni të përmend në shifra konkrete për këto 7 drejtime listën e programit buxhetor të mbrojtjes për vitin 2020: planifikimi, menaxhimi dhe administrimi, e kanë buxhetin 1 miliardë e 209 milionë lekë, 4,9% e buxhetit të mbrojtjes. Forcat e luftimit, që është drejtimi kryesor i politikës së mbrojtjes dhe i buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes, 10 miliardë e 273 milionë e 335 mijë, ose 41,4% e buxhetit të mbrojtjes. Arsimimi ushtarak shkon në 600 milionë e 50 mijë, mbështetja e luftimit shkon në 6 miliardë e 445 milionë e 910 mijë, ose 26% e buxhetit të mbrojtjes dhe që lidhet me forcat e luftimit që ju përmenda më sipër. Mbështetja për shëndetësinë është 895 milionë e 550 mijë, ose 3,6% e buxhetit të mbrojtjes, mbështetja sociale për ushtarakët shkon në 5 miliardë e 60 milionë, ose 20,4% e buxhetit, dhe emergjencat civile 315 milionë lekë, ose 1,3% e buxhetit të mbrojtjes.

Këtu do të doja mirëkuptimin tuaj, që në vijimësi dhe në rakordimin që do të bëjmë me Ministrinë e Financave për të arritur te shifra konkrete, do të donim që, meqenëse në programin tonë është ringritja e Akademisë Ushtarake, të bëhet një ndryshim i vogël për të kaluar një pjesë të buxhetit nga forcat e luftimit tek arsimi ushtarak. Për shifrën konkrete do të bisedojmë teknikisht gjatë seancave të mëvonshme nën drejtimin dhe me bashkëpunimin e drejtorit të Financave në Ministrisë së Mbrojtjes.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi!

Doja t'u thosha kolegëve që kanë përpara një material të punuar nga këshilltarët e Komisionit të Sigurisë për shifrat e buxhetit. Në fakt, jemi munduar të marrim shifrën e 2019-ës meqenëse nuk është mbyllur, si dhe shifrën që planifikohet për vitin 2020. Për disa nga drejtimet kryesore të përdorimit të buxhetit këshilltarët e komisionit kanë hartuar pikat ku buxheti vjen me rritje dhe ku ka një ulje të lehtë. Sipas tabelës që kam përpara, planifikimi, menaxhimi dhe administrimi kanë një ulje të lehtë, ndërkohë që buxheti vjen me rritje për forcat e luftimit, për arsimin ushtarak, për mbështetjen për shëndetësinë, për mbështetjen sociale për ushtarakët dhe për emergjencat civile.

Sidoqoftë, nga ajo që konstatoj, por që mund ta kenë konstatuar edhe kolegët ka diçka që duhet ta rakordojmë më saktë, se ka një mospërputhje, jo e rëndësishme, por që duhet të jemi të saktë në shifra që raportojmë për buxhetin e këtij viti dhe të vitit që vjen.

Unë do t'ia jap menjëherë fjalën zotit Qefaliaj, si relator për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe kolegët janë të lutur të hapin diskutimin nëpërmjet pyetjeve.

Faleminderit!

Xhemal Qefaliaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, ashtu si zoti Koçi edhe ju ishit shtruese, edhe pse informacionin e kemi mbi tavolinë, por do të sjell në vëmendje të kolegëve që gjëja e dukshme për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes është se duhet fokusuar tek ajo çfarë ka realizuar në vitin 2019, gjë për të cilën një pjesë e komisionit, ndoshta jo kolegët e rinj, kanë marrë pjesë në aktivitetet që ka organizuar Ministria e Mbrojtjes. Është shumë e rëndësishme të sjellim në vëmendje në këtë projektbuxhet, që i gjithë buxheti i përcaktuar në vitin 2019 ka kaluar dhe është shfrytëzuar me kapacitet të plotë dhe kjo ka shkuar kryesisht në zhvillimin e kapaciteteve të FA-së dhe në planin afatgjatë të zhvillimit. Njëkohësisht, ata që janë ushtarakë e kuptojnë shumë mirë, ka qenë një detyrë e kahershme për të

vijuar në pajisjen e forcave tokësore më një armatim të ri ndërveprues në raport me aleatët e NATO-s. Kjo ka bërë të mundur që ky buxhet të shtrihet në mënyrë të dukshme në infrastrukturë dhe në përmirësimin e mjedisit të punës së ushtarakëve.

Gjëja e veçantë lidhur me këtë buxhet është se pranë këtij dikasteri janë atashuar edhe emergjencat civile, ku vendi ynë këtë vit ka qenë shumë i detyruar të provohej në ngjarje të tilla të emergjencës, si të përmbytjeve, qoftë të tërmetit por edhe të zjarreve dhe është bërë e mundur që me buxhetin e akorduar për Ministrinë e Mbrojtjes të realizohen në shkallën më të lartë.

Cfarë ka të re buxheti për vitin 2020? Unë nuk do të ndalem në shifra, pasi çdo kolegjato i ka përpara, por zoti Koçi ishte shumë shterues kur përmendi se ai që është angazhim determinant, kryesor i Ministrisë së Mbrojtjes është ajo që është e vendosur edhe në Samitin e NATO-s të Wellsit, ku kërkohet që buxheti t'i ofrohet 2%-shit të buxhetit të përgjithshëm. Edhe këtë vit, siç e pohoj zoti Koçi, përsëri kemi rritje në shifrat, në mos gaboj në 1,36% ishte shifra që ka kaluar ajo 1,33. Ky është një tregues shumë i mirë që të bën të shpresosh që në fund të vitit 2024 të arrihet shifra, detyrë e lënë edhe në këtë samit.

Kam diçka tjetër që dua ta evidentoj, është fokusuar nga Shtabi i Përgjithshëm, është punuar me seriozitet dhe ky buxhet shkon edhe në drejtim të rritjes profesionale të Forcave të Armatosura në kuadrin e bashkëpunimit me NATO-n, por ndikon drejtpërdrejtë edhe në lartësimin e figurës, integritetit të ushtarakut ndërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë dhe trajtimit të ushtarakut. Në këto kushte, mendoj zonja kryetare, që në varësi edhe të pyetjeve që do të kenë kolegët, por duke e parë në tërësi buxhetin, i ftoj kolegët ta miratojmë, pasi bëjmë një akt shumë të mirë, duke mbështetur Forcat tona të Armatosura që të jenë forca të denja përkrah aleatëve tanë të NATO-s.

Ermonela Felaj- Faleminderit, zoti Qefalia!

Siç e dini, ne kemi diskutimin në parim të projektbuxhetit, pas datës 5 dhjetor kur buxheti do të miratohet në parim në seancë plenare do të kemi edhe diskutimin nen për nen. Megjithatë e mira e kësaj mbledhje do të ishte që në përfundim të mbërrinim në nevojat konkrete që ka realisht Ministria e Mbrojtjes, nëse ato plotësohen, pasi ka ende mundësi për të financuar diçka më tepër ose për të përmirësuar diçka në mënyrën sesi bëhet shpenzimi i parave publike nga institucioni i Ministrisë së Mbrojtjes.

Fjala është për zotin Maliqi.

Lefter Maliqi - Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj zotin Koçi, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm si dhe përfaqësuesit e tjerë.

Ne si anëtarë të Komisionit për Sigurinë pavarësisht pozicionit politik jemi në mbështetje të strukturave të mbrojtjes për një buxhet edhe më të lartë, për paga më të mira, për kushte më të mira. E vërteta është që edhe sipas relatorëve, por edhe sipas analizës faktike viti 2020 planifikohet me një deficit 1,6%. Po kështu është parashikuar një rritje ekonomike 4,1%, por edhe për mua, por besoj se edhe për qytetarët e tjerë kjo rritje nuk është e besueshme. Megjithatë Ministria e Mbrojtjes nuk duhet të jetë e kënaqur, për rritjen e buxhetit të vitit 2020 në krahasim me vitin 2019, sepse me sa di unë, në shtesë kemi edhe emergjencat civile, të cilat para 1 viti buxheti i tyre kaq nënë në varësinë e Ministrisë së Brendshme.

Ne nuk duhet të jemi të vetëkënaqur për pagat, pasi ne, Ministria e Mbrojtjes jemi pjesë e NATO-s dhe ato nuk janë të kënaqshme. Edhe përfaqësuesit tanë në NATO apo kudo që janë atashuar atashetë ushtarakë nuk janë në nivelet që duhet dhe interesi i madh është që të jenë edhe më të larta, po kështu edhe investimet.

Pyetjet e mia kanë të bëjnë me këto drejtime.

E para, në këtë projektbuxhet tek investimet që folët më parë, a ka ndonjë investim shtesë, meqenëse ka qenë problematike puna e radarëve në vijat kufitare bregdetare? Si qëndron problemi i tyre? A ka ndonjë mangësi e kështu me radhë?

E dyta, është parashikuar rritje page gjatë vitit 2020 për trupat e mbrojtjes, sidomos ata që janë të atashuar në NATO, në Bruksel dhe në vendet e tjera? Jashtë buxhetit, sepse e di që nuk është pjesa juaj, meqenëse shefin e Shtabit të Përgjithshëm e kemi nga Berati, edhe kryetaren e Komisionit të Sigurisë e kemi nga qarku i Beratit, në vitin 2018 ju premtuat se NATO do të fillonte investimin në bazën ajrore të Vlorës. A ka ndonjë të dhënë, të paktën ta dimë, kur do të fillojë, e dimë që nuk është buxheti i shtetit, por ka ndonjë të dhënë që ta dimë të saktë, nga informacionet që keni ju se kur do të fillojë ky investim i madh për qarkun e Beratit, për banorët e Kuçovë, si dhe për rëndësinë strategjike që ka për rajonin?

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Maliqi!

Ju falënderoj për pyetjet! Besoj se ndajmë të njëjtat pyetje, disa nga këtu. Për vëmendjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Mbrojtjes për pyetjen e parë do të desha t'i bashkëngjitesha edhe unë zotit Maliqi, ne si komision, apo një pjesë e mirë jona ka qenë te QNOD-ja dhe ka pasur rast nga afërt të shikojë jo e mjediset e punës, por të diskutojmë për të gjitha problematikat që ka institucioni atje. Do të ishte vërtet me interes për të kuptuar nëse Ministria e Mbrojtjes planifikon

ndonjë lloj investimi te kjo qendër. Po aq me inetr është edhe pyetja tjetër, për bazën ajrore të Kuçovës, e cila nuk është një bazë ajrore që i shërben thjesht dhe vetëm interesave lokale, por është më gjerë sesa kaq, sepse u shërben interesave të aleancës sonë ushtarake me NATO-n dhe normalisht sa herë që kemi pasur takime më përfaqësues të lartë të NATO-s ka qenë një pyetje, për të cilën kemi dashur gjithmonë të marrim informacion në vijimësi. Jemi të qartë se investimi nuk është i tillë që e zbaton pala shqiptare, por është një investim i aleancës, por duam të jemi sa më afër ose sa më konkretë me momentet e fillimit të këtij investimi.

Petro Koçi - Po i përgjigjem edhe në parim pyetjeve. Ndërkohë mund të ketë ndërhyrje edhe nga kolegët që kam në krah për ndonjë gjë edhe më konkrete.

Për pyetjen e parë për investime shtesë këtë vit në sistemin e survejimit të hapësirës detare, duhet të theksojmë se për herë të parë Shqipëria ka blerë një sistem të survejimit, të vëzhgimit të hapësirës ajrore me një sistem 22 milionë dollarë që përfundojë programin e buxhetimit këtë vit. Pra, është sistemi dhe qendra e këtij vëzhgimi në Medë, në rrethin e Pukës. Ky është investimi më i rëndësishëm si kapacitet për Shqipërinë dhe është një sistem kapacitet i koordinueshëm me Aleancën.

Lidhur me survejimin e hapësirës detare është një vëmendje e shtuar jo vetëm e dikasterit tonë, por edhe e ministrive të tjera. Ju e dini që hapësira detare është interes jo vetëm i Ministrisë së Mbrojtjes, sepse ka rojën bregdetare, por është edhe i ministrive të tjera, asaj të Brendshme, të Mjedisit, të Transportit, të Bujqësisë që ka peshkimin e të tjera. Këtë vit është blerë softi, i sistemit aktual të survejimit të hapësirës detare. Ky është një investim i rëndësishëm, por duke e llogaritur tani në raport me sistemin që mungonte fare, ky mund të duket minor, por meqenëse është një sistem në funksion blerja e softit ishte një gjë shumë e rëndësishme.

Pyetja e dytë ka lidhje me rritjen e pagave, dua të them se kjo është një politikë qeveritare, nuk lidhet drejtpërdrejt me buxhetin që paraqet një dikaster kur paraqitet në parlament, por duhet të themi se këtë viti u bë një rritje e konsiderueshme e pagave pas shumë vitesh për herë të parë në Forcat e Armatosura, duke përfshirë edhe disa kompensime të tjera që shkojnë në favor të një mirëqenie më të mirë për njerëzit me uniformë.

Për sa i përket Kuçovës ky është një angazhim yni me rëndësi gjeostrategjike, është përgjegjësi e NATO-s, buxheti i NATO-s, por ne kemi detyrimet tona që lidhen me shpronësimet, por edhe me përmirësimin e infrastrukturës, është ngritur komisioni përkatës që do të fillojë të merret me shpronësimet, kryetari i këtij komisioni jam unë, si zëvendësministër i Mbrojtjes. Jemi

në proces. Drejtori i Politikave që luan rolin e sekretarit të Përgjithshëm, për të shuar ndonjë kureshtje do të japë disa detaje më shumë.

Për sa i përket QNOD-së edhe ky është një interes i rëndësishëm kombëtar, ku Ministria e Mbrojtjes ka vetëm një pjesë të funksioneve dhe të përfshirjes. Ne jemi të angazhuar drejtpërdrejtë në mirëmbajtjen e sistemit, duke lidhur një kontratë me prodhuesin e këtij sistemi. Besoj se edhe kjo është e rëndësishme për sa i përket mirëfunksionimit të kësaj qendre, që është një qendër ndër-institucionale e operacioneve detare, që përfshin të gjitha ministritë dhe dikasteret që kanë interes në hapësirën detare.

Dua t'ia jap fjalën drejtorin e Politikave për ndonjë gjë më tepër.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Florian Kali - Zonja kryetare, në lidhje me bazën e Kuçovës, pa dyshim është një prioritet që Ministria e Mbrojtjes po e ndjek. Projekti është në një stad të tillë që agjencia e specializuar e NATO-s e prokurimeve, ka mbaruar dhe është miratuar projekti dhe studimi i fizibilitetit të bazës së Kuçovës, pritet që në strukturat e NATO-s siç janë Komiteti i Investimeve të kalojë projekti për fillimin e prokurimit. Viti 2020 6 maji i parë shënon edhe fillimin e punimeve në bazën e Kuçovës. Sipas afateve që ka deklaruar edhe Aleanca brenda trevjeçarit të parë do të përfundojë e gjithë baza e Kuçovës.

Ermonela Felaj- Po, zoti Vorpsi.

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti Koçi ju falënderoj për atë që paraqitet në lidhje me projektbuxhetin e vitit 2020. Natyrisht rritja e buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes tregon besimin që ka qeveria për rritjen ekonomike prej gati 4,1% dhe detyrimin që ne kemi ndaj Aleancës së Atlantikut.

Unë lexova me vëmendje shifrat, por ajo që kam merak për shkak edhe të informimit, të detyrës që kam pasur më parë, ka lidhje gjithmonë me emergjencat civile. Ne së bashku kemi kaluar një projektligj shumë të rëndësishëm atë “Për emergjencat civile” dhe një strukturë të re, Agjencinë Kombëtare. Pyetja ime është: a është parashikuar në këtë projektbuxhet kjo strukturë e re? A janë parashikuar investime në logjistikë dhe në infrastrukturën e kësaj agjencie?

Pyetja e dytë ka të bëjë me një detyrim të mbartur ndaj qytetarëve shqiptarë, dihet se kjo agjenci më parë ka qenë nën varësinë e Ministrisë së Brendshme dhe në momentin që e keni marrë, keni mbartur me vete edhe detyrime. Këto të fundit, të paktën në informacionin tim kanë qenë

rreth 700 milionë lekë të rinj apo 7 miliardë lekë. Ka pasur një lloj zbutjeje këta 2 vjet, por atë mund të ma thoni ju, a keni parashikuar për t'i kompensuar këta njerëz që kanë vite që presin këtë kompensim në këtë buxhet? Pa llogaritur edhe mbivendosjen tjetër në detyrim që kemi për shkak të fatkeqësive që kemi hasur këtë kohë me tërmetin apo me përmbytjet?

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Vorpsi për ndërhyrjen tuaj!

Është shumë e rëndësishëm që të kuptojmë se çfarë ndodh me emergjencat civile, besojmë se ligji i ri i ndau përgjegjësitë qartazi, sepse merr edhe pushteti lokal përgjegjësitë e tij dhe do të jetë viti i parë që buxhetet lokale do të planifikohen në mënyrë të tillë që 4% e tyre dedikohet për përballimin e emergjencave civile. Megjithatë vërejmë se ka një rritje për buxhetin e emergjencave civile diku në mos gaboj te 1 miliard lekë të vjetër, sipas asaj që mua më rezulton ose 10 milionë lekë. A do ta kemi më në fund Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile? A do të mund ajo të performojnë ashtu si ne kemi premtuar, që të bëhet pjesë e referimit të mekanizmi evropian për mbrojtjen civile?

Petro Koçi – Ashtu siç e thatë edhe ju, ka një rritje të lehtë për sa i përket emergjencave civile, gjithmonë në përputhje me projektin e ngritjes së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, por në pritje të disa VKM-vë që lidhen me strukturën e kësaj agjencie, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave mund të kemi rirregullime të buxhetit për sa i përket kësaj pjese, pra për sa i përket strukturës së agjencisë.

Unë jam dakord me atë që thoni ju, që ligji i ri i mbrojtjes civile, që ne kemi kaluar bashkë dhe që ka pasur shumë debate në lidhje me detyrimet që i përkasin pushtetit vendor, sjell një qasje të re në trajtimin e përballimit të risqeve të fatkeqësive natyrore. Ndërkohë, dua të theksoj që ku ka fatkeqësi konkrete, siç ka ndodhur edhe këtë vit, duhet të dini se buxheti i shtetit është investuar përtej buxhetit që ishte parashikuar në fillim të vitit. Tashmë kjo është një praktikë e konsoliduar e qeverisë shqiptare, kështu që ne nuk urojmë asnjëherë që të ndodhim fatkeqësi natyrore, por e vërteta është se ato janë duke u shtuar, sidomos për shkak të klimës që ka ndryshuar. Megjithatë, gjithmonë për këto raste, qeveria është e angazhuar me fonde shtesë përtej parashikimit të buxhetit vjetor.

Për sa i përket pyetjes së dytë që bëri zoti Vorpsi, edhe këtë vit 130 milionë lekë nga pjesa për emergjencat civile është për të kompensuar një pjesë të atyre familjeve që deri më sot janë konsideruar dhe që janë certifikuar nga ajo që quhej deri tani Drejtoria e Emergjencave Civile, që kanë nevojë për kompensim në përputhje me kriteret që ka VKM-ja përkatëse.

Po të pyesësh çdo dikaster më vete, të gjithë janë të pakënaqur, megjithëse buxheti rritet, sepse të gjithë do të donin shumë më tepër për drejtime të ndryshme, por ajo që është themelore është që ky është një buxhet që vjen në rritje, që përballon nevojat për rinovim dhe shtim të kapaciteteve tona mbrojtëse, që përballon angazhimet e Shqipërisë me Aleancën dhe me misionet e tjera ndërkombëtare, ku ne jemi dedikuar për shkak të politikave tona të paqes dhe të stabilitetit në botë dhe që ka rritje në disa fusha, sic është arsimimi apo mbështetja sociale për ushtarakët.

Këto janë themelore. Objektivi i arritjes së 2%-shit në vitin 2024 është realisht i realizueshëm, kështu që mendoj se te kjo pjesë e diskutimit, e shqyrtimit në parim të projektbuxhetit, jemi në pozitat kur duhet të marrim si Ministri Mbrojtjeje dakordësimin e këtij komisioni dhe pastaj të parlamentit.

Kur të kalojmë te buxheti nen për nen (do të bëjmë edhe atë korrigjimin që unë me shumë mirëkuptim e kërkoja më parë) është më e udhës të kemi pastaj edhe diskutime edhe më specifike.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Të nderuar gjeneralë dhe të ftuar të Ministrisë së Mbrojtjes,

Sikurse u theksua këtu, është për t'u përshëndetur dhe për t'u vlerësuar fakti që ka një rritje në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe kjo reflektohet vit pas viti. Padyshim që kemi disa detyrime dhe vetë ne kemi marrë një mbështetje, por që, nga ana tjetër, kjo mbështetje kërkon edhe detyrime që reflektohen në këtë buxhet.

Shqipëria është vend anëtar i NATO-s, por, nga ana tjetër, ka edhe detyrime të tjera. Unë nuk do të futem në shumë detaje, pasi do të kemi rast të flasim nen për nen, por doja vetëm një sqarim, zoti zëvendësministër, për sa i përket pjesës “Mbështetja për shëndetësinë”.

Në dijeninë time Spitali Ushtarak ka kaluar në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, prandaj dua të di për çfarë konkretisht bëhet fjalë këtu.

Ju e përmendët mbështetjen sociale për ushtarakët. Çfarë nënkuptohet konkretisht me këtë?

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Urdhëroni!

Nuri Laknori– Përshëndetje të nderuar,

Jam drejtori i Drejtorisë së Financave në Ministrinë e Mbrojtjes.

Në programin buxhetor “Mbështetja për shëndetësinë” përfshihet Spitali Universitar i Traumës, që realisht ka qenë pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe është ripërfshirë në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes. Në këtë program buxhetor është vetëm kjo njësi shpenzuese, Spitali Universitar i Traumës, dhe shpenzimet për këtë program buxhetor përfshijnë të tria kategoritë e shpenzimeve, që janë shpenzime korente, shpenzime për personelin dhe shpenzime për investimet.

Ka një rritje të buxhetit për këtë program buxhetor, nisur edhe nga nevojat në rritje të Spitalit Universitar të Traumës, sipas kërkesave dhe fluksit të madh që ka ky spital.

(Diskutime pa mikrofon)

Ka një lidhje të dyfishtë me Ministrinë e Shëndetësisë. Faktikisht, varësia buxhetore është nga Ministria e Mbrojtjes, ndërsa varësia administrative e Spitalit Universitar të Traumës është nga Ministria e Shëndetësisë, gjithashtu përfiton edhe nga fondi i Sigurimit Shëndetësor të Detyrueshëm, është pjesë e skemës së fondeve të cilat merren nga fondi i Sigurimit Shëndetësor të Detyrueshëm.

Në programin “Mbështetja sociale për ushtarakët” përfshihen shpenzimet për pensionet e parakohshme të ushtarakëve. Në këtë kategori përfshihen një sërë funksionesh ushtarake, të cilat marrin pension të parakohshëm, ndër të cilat përmendim detarët, ata që kanë punuar me rrezatim, gjithashtu edhe funksionet organike të pilotëve të Forcave të Armatosura. Bëhet fjalë vetëm për pensionin e parakohshëm dhe jo për pension pleqërie.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Po i rikthehem pyetjes së zonjës Gjebrea, se, të them të drejtën, kurrë nuk e kam kuptuar pse duhet që Spitali Universitar i Traumës, që e njohim të gjithë si Spitali Ushtarak, të ketë këtë varësi të dyfishtë. A ndodh kjo vetëm për shkak të historisë së këtij spitali, që dikur i ka shërbyer FA-së?

Do të doja të dija mendimin tuaj konkretisht. A është kjo një peshë për Ministrinë e Shëndetësisë, apo është një nevojë që ta ketë këtë spital, ndërkohë që dimë se është spitali më i madh ose i vetmi në rang republike që trajton të gjitha trumat, edhe ato që shkojnë në QSUT, të

gjitha trajtohen në këtë spital (të paktën, kjo është një njohje e jashtme, aq sa e kanë të gjithë qytetarët).

Do të doja të dija mendimin tuaj. A ka nevojë Ministria e Mbrojtjes ta ketë këtë qendër dhe për çfarë konkretisht?

Petro Koçi – Kjo ka qenë kështu përpara se të vinte kjo qeveri në pushtet. Në fillim u mendua të bëhej një ritransferim, për ta risjellë në Ministrinë e Mbrojtjes, ndërkohë situata ishte e komplikuar dhe, me sa duket, ishte e vështirë të bëhej një rikthim total, nën administrimin e Ministrisë së Mbrojtjes, prandaj u gjend një formulë mikse.

Gjithsesi, ky është një vendim qeverie që e tejkalon kompetencën dhe fuqinë propozuese menaxhuese të Ministrisë së Mbrojtjes, për shkak të atij realiteti përballë të cilit u gjendëm. Unë mendoj se ka nevojë për ta përmirësuar këtë mënyrë funksionimi të atij spitali, për të rritur edhe më shumë mundësinë që ushtarakët tanë të gjejnë zgjidhje për sa i përket mbështetjes me politikat shëndetësore, të cilat janë detyrime në përputhje me ligjin “Statusi i ushtarakut”.

Nga ana tjetër, dua të theksoj se për sa i përket buxhetit për shërbimet shëndetësore, këtu ka edhe një pjesë tjetër që nuk është brenda asaj shifre, sepse i gjithë personeli mjekësor, që janë pranë reparteve, nuk janë pjesë e kësaj, sepse përfshihen te pagesat për personelin në përgjithësi, pra ata nuk përfshihen te kjo shifër.

Ermonela Felaj – Faleminderit për sqarimin!

Urdhëroni, zoti Maliqi!

Lifter Maliqi – Ka një ankesë të herëpashershme të punonjësve të Uzinës në Mjekës të Gramshit dhe të Uzinës së Poliçanit, të cilët kanë mbi një vit e gjysmë pa marrë pagat. Sa e vërtetë është kjo? Si qëndron çështja?

Petro Koçi – Të gjitha këto raste janë shqetësimi ynë, sidomos nga pikëpamja sociale, por problemi më i madh është mënyra e administrimit të tyre, sepse janë sh.a., nuk janë në varësi financiare buxhetore nga Ministria e Mbrojtjes. Në të vërtetë, në shumë raste ka pasur shpërdorim nga ata që kanë drejtuar, nga bordet drejtuese e të tjera, dhe një pjesë e tyre janë zhytur në borxhe shumë të mëdha, por janë borxhe të tyre si ente më vete, nuk lidhen me borxhet që mund të kishte Ministria e Mbrojtjes.

Nga ana tjetër, janë disa probleme sociale, sepse aty ka punonjës që kanë punuar për vite të tëra në profesione që quhen “relativisht të vështira” dhe me pasoja për shëndetin dhe për to jemi

duke bashkëpunuar me Ministrinë e Financave, që të gjendet mundësia e trajtimit të tyre në përputhje me vitet e punës.

Për sa u përket atyre që punojnë aktualisht, kjo e gjitha çështje e bordeve dhe e drejtuesve përkatës në Poliçan dhe në Mjekës. Për mendimin tim personal, është një çështje që kërkon një zgjidhje, sepse prapa ka probleme financiare dhe besoj edhe përgjegjësi penale.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Duzha!

Luan Duzha – Në vijim të kësaj, dua të theksoj se ky problem është në Mjekës, unë jam deputet i zonës dhe e njoh mirë problemin (kam qenë edhe drejtor i Mjekësit për ca kohë).

Ka mbi 6 muaj që punëtorët nuk i kanë marrë pagat. Kanë bërë edhe një gjyq dhe kanë fituar, kanë dalë edhe te Fiks-i apo Stop-i, më duket, dhe akoma këtë paga nuk janë paguar.

Është e vërtetë ajo që thatë ju, se aty ka një bord që vendos. Janë të vetmet sh.a. që kanë ngelur këto uzina ushtarake. Është totalisht faji i atij bordit që vazhdon të t'i mbante punonjësit në punë pa pasur buxhetin e nevojshëm, megjithatë unë do të bëja me faj edhe Ministrinë e Mbrojtjes që e la kaq gjatë këtë bord që të gabonte. Pra, “faji” i Ministrisë së Mbrojtjes është se i la kaq gjatë këto borde të mos i paguanin punëtorët.

E dyta, çfarë do të bëhet me këto uzina ushtarake? A ka fonde Ministria e Mbrojtjes për t'i mbajtur këto uzina dhe sa shkon kjo kosto, duke filluar nga taksa e pronës, që e diskutuam edhe me drejtorin e financës? Çfarë do të bëhet?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Duzha!

Në fakt, duhet thënë që Ministria e Mbrojtjes më herët ka qenë me opsionin e punonjësve që t'u njihej një status i veçantë. Shpresojmë të vijë momenti oportun që të gjejë edhe mbështetje financiare, sepse asnjëri prej nesh këtu nuk besoj se është kundër mbështetjes financiare për ata punonjës që kanë dhënë jetën në ato uzina apo njësi të prodhimit të materialeve ushtarake.

Nuri Laknori – Për të përforcuar atë që ju thatë, zonja kryetare, Ministria e Mbrojtjes ka ndërmarrë disa nisma ligjore me Ministrinë e Financave dhe me aktorë të tjerë në rol, por statusi i ndërmarrjeve kërkon një vendimmarrje më të gjerë për detyrimet që këto ndërmarrje bartin.

Për nga vetë natyra e punës së ndërmarrjeve, mund të them që Ministria e Mbrojtjes ka lidhur një kontratë për demontim lëndësh plasëse me ndërmarrjen e Mjekësit, ku garantohen pagesat dhe detyrimet e prapambetura që kanë ndaj punonjësve. Problem mbetet ndërmarrja e

Poliçanit, sepse për nga vetë natyra e punës në këtë ndërmarrje është pothuajse e pamundur gjetja e një fronti pune për t'i dhënë ndihmë kësaj ndërmarrjeje.

Që fabrika e Poliçanit të mbahet në punë duhet të bëhet demontim municionesh, por Ministria e Mbrojtjes e ka përmbushur këtë zë dhe nuk ka më municione, konkretisht fishekë, për të demontuar demontuar në Poliçan. Për sa u përket kostove që Ministria e Mbrojtjes duhet të ketë të parashikuar në buxhet, nisur nga statusi i tyre, siç e tha edhe zëvendësministri i Mbrojtjes, nuk mund të planifikojmë para për ndërmarrjet buxhetore, sepse janë ndërmarrje ushtarake dhe veprojnë sipas ligjit për ndërmarrjet; janë sh.a. Për sa u përket kostove për pagesa taksash dhe pagesa të tjera vendore jemi në shqyrtim edhe me aktorë të tjerë për të bërë të mundur minimizimin e tyre, duke marrë përsipër Ministria e Mbrojtjes një pjesë të territoreve që nuk përdoren nga uzinat.

Faleminderit!

Petro Koçi – Janë në një situatë që kërkon zgjidhje, ku të përfshihet jo vetëm Ministria e Mbrojtjes, por duhet të përfshihet patjetër edhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe qeveria në përgjithësi.

Ne jemi përpjekur të sigurojmë edhe kontrata pune. Për shembull, jemi munduar të gjenim edhe fishekë, që të vinin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për t'i demontuar në ndërmarrjen e Poliçanit, por ka qenë e pamundur. Kemi shfrytëzuar çdo forum dhe çdo kontakt me Ministri të tjera të Mbrojtjes, qoftë edhe në kuadrin SISAC-ut, që të mund të bënim demontim dhe të hapnim front pune për këto njësi. Nga ana tjetër, kemi bërë edhe përpjekje për të realizuar kontrata me subjekte të tjera, që të mund t'i rivinin në punë me teknologji moderne këto uzina, por deri tani nuk është realizuar dot.

Kështu që, mbetet për detyrë të jepet një zgjidhje me themel për mënyrën si funksionojnë këto sh.a tani, por edhe për probleme sociale që kanë punonjësit apo ish-punonjësit e këtyre ndërmarrjeve ushtarake, siç edhe ne jemi përpjekur dhe po përpiqemi të bëjmë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Ju lutem, më konfirmoni, ndërmarrja e Mjekësit filloi nga puna, sepse para 2 vjetëve dëgjuam që do të fillonte punë për prodhimin e fishekzjarrëve? Di që për uzinën e Poliçanit ka pasur interes për prodhimin e pistoletave. Apo ju jeni fokusuar vetëm te proceset e demontimit? A është e mundur që këto të rikthehen në ndërmarrje prodhuese, qoftë të fishekzjarrëve, qoftë të pistoletave, pra, të armatimit të lehtë në përgjithësi?

Petro Koçi – Uzina e Poliçanit shërben për prodhim fishekësh, por ajo është teknologji e konsumuar dhe e amortizuar. Janë bërë përpjekje për të gjetur operatorë të tjerë, që plotësojnë standardet e sigurisë, të cilët të mund të investojnë aty, por edhe të shfrytëzojnë profesionalizmin dhe kapacitetin njerëzor që gjendet atje. Ndërkohë, vitet bëjnë të tyren, sepse këto janë kapacitete dhe profesione që janë duke humbur. Pra, duhet një zgjidhje në themel për mënyrën si ato funksionojnë, ku të përfshihen edhe këto mundësi që thamë, mundësi investitorësh dhe lidhesh kontratash. Zgjidhja tjetër është statusi social i punonjësve apo edhe i ish-punonjësve.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

E do fjalën dikush prej kolegëve?

Atëherë, më lejoni të bëj edhe unë dy pyetje.

Së pari, dua informacion për ndihmën e huaj. Sa ka qenë ndihma e huaj gjatë vitit 2019 për Ministrinë e Mbrojtjes? Ne kemi një informacion sidomos për bashkëpunimin tuaj me palën turke. Nëpërmjet bursave të ndryshme të studimit shumë studentë studiojnë atje në akademi tokësore, detare, të mbrojtjes, por edhe në universitetin e mjekësisë. Gjithashtu, vazhdon ndihma e ndërsjellë që shteti turk i jep palës shqiptare nëpërmjet dërgimit të shtetasve shqiptarë në spitalet ushtarake atje. Nga sa informacion kam unë, vetëm këtë vit janë çuar të paktën 100 shtetas. Pra, a mund të na jepni ndonjë informacion më tepër për këtë çështje dhe ndihmën turke në veçanti?

Së dyti, dua t’ju pyes për kontrollin që ju keni kaluar nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën 2017-2018. Për informim të publikut, si ka rezultuar performanca e Ministrisë së Mbrojtjes sipas këtij kontrolli? Kontrolli i Lartë i Shtetit është organ kushtetues, prandaj është mirë që edhe ne në Komision i Sigurisë të fillojmë të vendosim një ballafaqim të punës suaj me të dhënat që ky kontroll i ka vënë në dispozicion këtij komisioni, qoftë për ministrinë tuaj, qoftë për Ministrinë e Brendshme.

Petro Koçi – Për sa i përket ndihmës së partnerëve, duhet të themi që, së pari, i shprehim mirënjohje Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe të tjerëve që janë shumë aktivë për të asistuar rritjen e kapaciteteve në Forcat tona të Armatosura. Besoj se për një pjesë të këtyre edhe ju jeni në dijeni, sepse shpeshherë janë zhvilluar aktivitete publike, që kanë shënuar fillimin apo përfundimin e dhënies së këtyre ndihmave. Një nga drejtimet është edhe mbështetja direkte financiare, por që në rastin e Turqisë është e kushtëzuar me blerjet nga industria ushtarake turke. Ajo është një ndihmë e përvitshme që ndonjëherë nuk realizohet, por që bartet vit pas viti. Rezulton që vitin që vjen kjo ndihmë do të shkojë në 16 milionë dollarë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E shtrirë në vite dhe duke u akumuluar mbërrijmë në këto shifra.

Sigurisht që ne jemi aktivë dhe të vëmendshëm për të plotësuar gjithmonë në kohë të gjitha kushtet që parashikojnë kontratat e realizimit të ndihmave të tilla. Kjo përbën një arsye më shumë për të qenë më optimistë për fuqizimin e kapaciteteve dhe modernizimin e Forcave tona të Armatosura.

Për sa u përket rezultateve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, janë marrë masa me largim nga puna, por edhe masa të tjera deri në ndjekje penale. Nëse ju duhet ndonjë përgjigje më konkrete, mund t'i drejtoheni drejtorit të financave. Në parim ne e kemi konsideruar gjithmonë si ndihmë Kontrollin e Lartë të Shtetit. Duke pasur parasysh edhe auditin e brendshëm, që ka vetë ministria, inspektimin e përgjithshëm dhe angazhimin e dy institucioneve të tjera, që janë edhe më të mirëfillta ushtarake, siç është AISM-ja, Agjencia e Inteligjencës, por edhe Policia Ushtarake, ne veprojmë në çdo rast që konstatohen abuzime dhe shpërdorime, që ndonjëherë janë edhe të karakterit financiar, në funksionimin e administratës apo të personelit në Ministrinë e Mbrojtjes apo në Forcat tona të Armatosura.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zoti Laknori, mund të shtoni diçka për raportin që unë citova?

Nuri Laknori – Për sa i përket raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, një nga detyrat që la KLSH-ja është rishikimi i bazës ligjore për blerjet e mallrave ushtarake. Ministria e Mbrojtjes deri tani ka operuar me një vendim të Këshillit të Ministrave për përjashtimin e blerjes së disa mallrave ushtarake. Ky vendim i Këshillit të Ministrave tashmë po kthehet në ligj me një kuadër më të gjerë dhe i përafëruar edhe sipas dispozitave ligjore europiane. Ndërsa për sa u përket masave disiplinore, ka pasur edhe masa për dëmshpërblim dëmi, të cilat janë marrë si ndaj operatorëve ekonomikë, ashtu edhe ndaj personelit të Forcave të Armatosura.

Ermonela Felaj – Fjala ishte për prokurimet e klasifikuara që ju po operoni?

Nuri Laknori – Po. Kurse për prokurimet e klasifikuara Kontrolli i Lartë i Shtetit ka dhënë një opinion të kualifikuar, mbi të cilin nuk ka pasur observacione.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Nëse nuk ka pyetje nga kolegët ...

Petro Koçi – Për sa u përket blerjeve apo prokurimeve për mallra ushtarake, kjo është pjesë edhe e paketës për integrimin europian. Pra, është një nga detyrimet e direktivave të BE-së

që në këtë fushë të kemi një ligj që përputhet me këtë direktivë, por gjithmonë duke pasur parasysh që një pjesë e këtyre blerjeve kërkojnë siguri të lartë dhe që ne duhet t'u shmangemi operatorëve që vijnë nga vende, të cilat nuk janë miqësore me NATO-n dhe natyrisht edhe me Shqipërinë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi dhe kolegët tuaj të Ministrisë së Mbrojtjes!

E mbyllim këtu diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”, për t’u ritakuar gjatë diskutimit nen për nen.

Kush është dakord me votimin në parim të këtij projektligji? Kundër dhe abstenime nuk ka.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

